



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.341/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Zyhdi Haziri dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Anita Peci, duke vendosur përkritazi me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Internews Kosova (IKS) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së Heshtjes Zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Internews Kosova (IKS) me seli në Prishtinë, e cila identifikohet me shenjën ZL.Anr.341/2017, e datës 22.10.2017, me të cilën kërkohet që ti shqiptohet dënimi me gjobë, subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), për shkak të Thyerjes së Heshtjes Zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

A r s y e t i m

Më datën 22.10.2017, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Internews Kosova (IKS) me seli në Prishtinë, me të cilën ka pretenduar se kandidati për Kryetar të Komunës së Prishtinës, Selim Pacolli, ditën e zgjedhjeve ka bërë fushatë zgjedhore, duke shpërndarë video duke votuar dhe duke bërë thirrje për votim, me mbishkrimin “Ftoj të gjithë qytetarët të ndajnë pak minuta të kohës së tyre për të votuar programin më të mirë për qytetin e tyre. Çdo votë është e rëndësishme! Selim Pacolli ! - 34”. Sipas parashtruesit të ankesës ky veprim, bie ndesh me nenin 36.1 pika a dhe b të LZP-Së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha dëshmit relevante në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar


Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës BIRN dhe Internews Kosova, lidhur me shkeljen e pretenduar nga ana e kandidatit për Kryetar të Komunës së Prishtinës, nga radhët e subjektit politik AKR, Paneli i vlerësoi se janë pa qëndrueshme dhe si e tillë e refuzoj ankesën, për faktin se, veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të nenit 36.1 pika b) e LZP-së, për arsye se nga provat e administruara në këtë rast nuk janë vërtetuar pretendimet ankimore se kandidati në fjalë ka thyer heshtjen zgjedhore për zgjedhjet lokale të datës 22.10.2017, sepse nga fotografit që gjenden në shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se deklarimi i kandidatit në fjalë ka karakter të fushatës zgjedhore.

Nga arsyet e theksuar më lartë dhe duke u bazuar në nenin 117 dhe nenin 118 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.341/2017 me datën 24.10.2017

Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.